

Gazeta El-Hilal, viti IV, nr. 22 nëntor-dhjetor 1990 faqe 7.

## PËRKTHIME - VËSHTRIME

M. A. KETTANI

### ISLAMI NË BALLKAN NË KOHËN PASOSMANE

Libri më i ri i Aleksandër Popoviqit L'islam Ballanique: Les musulmans de Sud – Est Europeen dans la periode Post – Ottomane (Berlin: Osteuropa Institut an der Frein Universitat Berlin, 1986, 493 faqe; librit i janë bashkangjitur edhe 17 letra, 17 shtojca, 1236 shënime. 28 tabela, 1452 referenca bibliografike dhe lista e titujve prej 338 gazetave islame) është vepër enciklopedike. Libri në fjalë, siç përmendet në hyrje, “është fryt i studimit dhjetëvjeçar, i hulumtimeve njëzetvjeçare, por prapsepapë ka lindur para kohe”. Libri gjithashtu është rezultat i ligjeratave që i mbante në Ecole Praticue des Hautes Etudes (tash Ecole des Hautes Etudes en Sciences Socilaes) në Paris, Francë.

Libri merret me studimin e pakicave muslimane në Ballkan pas rënies së Mbretërisë Osmane, në të cilin territor sot shihen gjashtë shtete: Jugosllavia, Bullgaria, Rumania, Greqia, Hungaria dhe Shqipëria, me sipërfaqe prej 861.980 kilometra katrorë me 81 milion banorë sipas regjistrimit të vitit 1988.

“Tema e këtij libri”, thotë autori në hyrje, “është historia për mirëmbajtjen (dobësimin, zhdukjen ose përtrirjen) e bashkësive muslimane të Evropës Lindore (Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Hungaria, Rumania, Jugosllavia) prej fundit të Mbretërisë Osmane gjer më sot”. Në fund ai sqaron: “Dy zhdukje, njëra nga kushtet “natyrore” (bashkësia muslimane në Hungari), tjetra në kushtet e imponimit (bashkësia muslimane në Shqipëri); tri raste të dobësimit, secili prej tyre si rezultat i veprimtarisë së represalieve të pushtetit vendas, por në forma të ndryshme; njëra në kushte absurde, duke marrë parasyshë numrin e banorëve muslimanë në krahasim me numrin e prëgjithshëm të atij vendi (bashkësia muslimane në Rumani); e dyta në kushte “të parashikuara”, duke u mbështetur në urrejtjen e thellë të cilën Greqia orthodoxe e ndienë ndaj “turkokratisë” dhe Islamit bashkësia muslimane në Greqi); e treta në ashpërsinë e bashkuar të nacionalizmit në

zhvillim e sipër dhe “ateizmit shkencor” në mënyrën sovjetike (bashkësia muslimane në Bullgari); një lindje e papritur (bashkësia muslimane në Jugosllavi)”.

Në vazhdim të shohim se çka thotë autori për secilën bashkësi dhe komentën e tij:

... **Zhdukja e dytë:** bashkësia muslimane në Shqipëri (kaptina I, 55 faqe). Edhe këtu Popoviqi beson se Islami në Shqipëri arriti me Qeverinë Osmane, që në këtë rast si duket është e vërtetë. Me të vërtetë ardhja e Osmanlinjëve filloje rreth viti 1385, ndlrsa mori fund në vitin 1478. Popoviqi thotë se islamizimi masovik i shqiptarëve arrihet në shekullin e 17 dhe 18. Shkaqet ekonomike dhe shoqërore si dhe islamizimin të cilin e përmend ai e lë pas dore simpatinë e Islamit si fe. Në këtë autori gabon si që gabojnë edhe shumë autorë të tjerë jomuslimanë kur e analizojnë fenomenin e islamizimit të këtyre trevave, të cilët kanë qenë të persekutuar bile edhe sot, nuk e lëshuan Islamin? Kah fundi i shekullit XIX, 70% pjestarët e popullatës shqiptare kanë qenë muslimanë, 20% ortodoks (në jug) dhe 10% katolik (në veri).

Pavarsinë nga Perandoria Osmane Shqipëria e shpalli në vitin 1912, andaj edhe dështuan planet për ndarjen e vendit nga ana e fqinjëve të krishterë. Edhe pse në shtet ekzistonte shumica muslimane, Islami nuk u shpall fe shtetërore. Muslimanët u vetorganizuan (prej vitit 1912 deri në vitin 1920) në dy bashkësi: sunnite (që përbënte shumica e popullatës) nën ushheqjen e shejhul-islamit në Stamboll dhe bashkësitë sufiste, e cila ishte e varur nga teqeja e Anadollit. Shkollë kryesore Islame ishte Medreseja e Beratit. Jeta fetare ishte shumë e zhvilluar dhe botoheshin shumë botime periodike dhe vepra të ndryshme në gjuhën shqipe. Të krishterët prapëprapë kishin shpresë, gjatë asaj kohe, se shqiptarët muslimanë do t'i kthejnë në fenë krishtere me ndihmën e shumë misionarëve. Orvatjet e tyre me të vërtetë dështuan plotësisht.

Në vitin 1921 lidhja me Stambollin është ndërprerë, kurse në vitin 1923 bashkësia sunnite organizoi Kongresin e saj të parë dhe e zgjodhi për herë të parë muftoiun e vet me seli në Tiranë si dhe themeloi Këshillin e lartë të sheriatit. Bektashinjtë pavarsinë e vet nga Turqia e fituan në vitin 1922. Në vitin 1925 në Tiranë u eminencua krytari i trye më i lartë, dede; Tirana në këtë kohë edhe ishte qendra e bektashizmit për tërë botën. Në kohën prej

vitit 1921 deri në vitin 1924 në Shqipëri u zhvillua një veprimtari Islam shumë e madhe dhe me 71% të popullatës muslimane Shqipëria nuk dallohej nga shtetet tjera muslimane. Shqipëria ishte shtet, popullësia e të cilit kryesisht ishte muslimane. Për herë të parë Kur'ani përkthehet në gjuhën shqipe si dhe botoheshin botime të ndryshme periodike dhe publikime tjera.

Kur fitoi Pavarësinë Shqipëria, Wiliam de Wed, i krishterë gjerman, u imponua mbret i shqiptarëve, kryengritja popullore e detyroi që ta lëshoi vendin para luftës së parë botërore. Atëherë u formua Këshilli i Lartë i Mëkëmbësisë. Këtë Këshillë e përbënin katër anëtarë: dy muslimanë (një bektashian dhe një sunni) dhe dy të krishterë (një kjetolik dhe një ortodoks). Në vitin 1925 Kuvendi popullor e shkarkoi mëkëmbësin dhe vendin e shpalli republikë në krye me muslimanin Ahmed Zogu si kryetar i parë. Zogu u detyrua ta lëshojë vendin në vitin 1939, kur Italia e okupo Shqipërinë një natë para se të fillonte Lufta e Dytë Botërore.

Gjatë vitit 1925-1939 bashkësia sunnite u organizua dhe mbajti Kongresin e dytë në Tiranë, në gusht të vitit 1929. Atëherë në Shqipëri aktive ishin 1048 xhami në të cilat punonin 1315 nëpunës. Një numër i rinisë shqiptare u dërguan që të mësojnë Islamin jasht vendit sidomos në Egjipt. U themelua Këshilli i lartë i bashkësisë në krye të cilit u zgjodh Kryetari i bashkësië nën mbikqyrjen e të cilit ishin edhe katër muftinitë (në Shkodër, në Tiranë, në Korçë dhe në Gjirokastër). Në vitin 1929 bektashinjtë në Korçë mbajtën Kongresin e tretë në të cilin shpallën pavarësinë e tyre shpirtërore dhe autonominë në suaza të Bashkësis Islame të Shqipërisë. Në krye të Bashkësis ishte “baba i madh” me seli në Tiranë të cilit i ndihmonin pesë babenjtë (në Gjirokastër, në Frashër, në Prishtë, në Korçë dhe në Elbasan). Shkolla sunnite Islame në Berat u mbill në vitin 1931 dhe u zëvendësua me medresenë e Lartë në Tiranë, ndërsa në të njëjtën kohë bektashinjtë kishin dy çerdhe të tyre (në Tiranë dhe në Korçë). Rendet e mistikëve (dervishëve) veprimtarinë e tyre të zakonshme e vazhduan pa kurrfarë pengesash, bile edhe botonin publikime të ndryshme.

Mbas vitit 1945, pas disfatës së Italisë fashiste, partia komuniste merr pushtetin. Atëherë për herë të parë Islami në Shqipëri i ekspozohet presionit, qëllimi i së cilës ishte që të tërhiqet tërësisht. Prej vitit 1945 deri në vitin 1955 sundimi komunist i hyri punës rreth deorganizimit të veprimtarisë të religjionit musliman duke i eliminuar fizikisht ulemanë e cila i kundëtvuhej

politikës së tyre, ata i zëvendësonin me marionetë sipas zgjedhjes vetanake. Shtypjen e publikimeve Islame e ndaluan krejtësisht, ndërsa fetat fetare ngadalë u fshini prej kalendarit festiv. Politika e mënjanimit të Islamit vazhdoi deri në vitin 1967. Deri në këtë kohë e evtmja lidhje me Islamine jashtëm mbahej me Bashkësinë Muslimane sunnite të uzbekistanit të Bashkimit Sovjetik. Në krye të së cilësishte Musa haxhi Aliu. Kjo lidhje vazhdoi deri në vitin 1950.

Në vitin 1967 pushteti shqiptarë zyrtarisht ndaloi fenë, duke përfshirë edhe Islamin, dhe Shqipërinë e shpalli si shtetë të parë ateist në botë. Të gjithaq xhamitë (edhe kishat) u mbyllën, ndërsa Islamin e mënjanonin në çdo mënyrë. Në vitin 1976 u shpall Ligji mbi ndërrimin e emrave me kuptim Islam, por si duket ky aksion qe i pasusesshëm. Popoviqi me ngurim të dukshëm pranon se islami në Shqipëru u shua në vitin 1967. Por, duhet të din se qëndrimi i pushtetit ndaj Islamit shumë vështirë mund të ndërrojë vullnetin e në populli. Vlerësohet se në vitin 1988 Shqipëria numronte rreth 3.140.000 banorë prej të cilëve përafërsisht 75% ose 2.350.000 banorë janë muslimanë ose pasardhëstë islamit.

Diasporën shqiptare, duke iu nashkangjitur edhe atë jugosllave, popoviqi e përfundon në mënyrë të përciptë. Emigrantët muslimanë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanda, në Evropën Perëndimore, në Australi dhe në Zelandën e Re ishin shumë aktiv në formimin e institucioneve Islame dhe nëpërgjithësi në rilindjen Islame, qoftë brenda organizatave Islame shqiptare qoftë edhe me muslimanët e tjerë. Në Evropën Perëndimore, shqiptarët muslimanë organizuan bashkësinë muslimane italiane me seli në Romë (fjala është për Lidhjen muslimane në Perëndim, të cilën e udhëheqte dr. Mentor Ciuko), të cilët njëherit kishin ndikim të madh në formimin e bashkësisë muslimane në Belgjikë. Në Itali ka rreth 10.000 shqiptarë muslimanë dhe rreth 300.000 jomuslimanë (në Sicili dhe Kalabri). Në Belgjikë ka rreth 10.000 shqiptarë muslimanë.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pranë shoqatës shqiptaro-amerikane muslimane në Harper Woods Michigan dhe Qendra shqiptaro-amerikane Islame në Brooklyn (N. Y.), të cilën e përmend Popoviqi, ekziston edhe bashkësia muslimane shqiptare Waterbury (Connecticut) e cila ka ndërtuar Qendrën Islamike. Megjithkëtë, disa shqiptarë në mënyrë aktive kontribuan në themelimin e Qendrës Islame në Anglinë e Re (Mass.) dhe në bashkësitë

tjeta. Në Kanada muslimanët shqiptarë në mënyrë efikase ndihmuan organizimin e Bashkësisë muslimane në Toronto.

Në Australi ka rreth 40.000 muslimanë shqiptarë, ata kanë organizuar Bashkësinë muslimane shqiptare në Canolton (në brendinë e paralagjes së Melburnit, shteti i Viktorisë) dhe ndërtuan xhaminë e parë në qytet në Shaperton (Victoria) dhe së shpejti në Dadenong (jasht paralagjes së Melburnit) si dhe në Marreb (Queensland). Shqiptarët muslimanë kanë anëtarësuar edhe në Shoqatën e muslimanëve në Pert (Australia Perëndimore), Adelaide (Asustralia Jugore), Sidney (N.S.U.) dhe Bisban (Queensland). Me rëndësi është të përmendim kontributin e shqiptarëve muslimanë për bashkimin e bashkësisë muslimane në Australi, ndërsa Kryetar i dytë i Federatës së Australisë për Këshillin Islamik (AFIC) është zotëri Haset Saliu, jurist Australian, i gjeneratës së parë, bir i një emigranti shqiptar nga Shappertoni. Gjithashtu muslimanët shqiptarë morrën pjesë në bashkimin e muslimanëve të Zelandës së Re (FIANZ) dhe ndër kryetarët e parë të kësaj shoqate është shqiptari nga Aucklandi, z. M. Krasniqi. Nëse diaspora Islame është aq e lidhur me Islamin, njëherit aktive në rilindjen e Islamit, ekziston shpresa se Islami në Shqipëri ende është i gjallë aty ku më së shumti vlenë: në zemrat e banorëve të atjeshëm dhe ka mundësi të paraqitet sa më parë. Duhet të përmendim se diaspora Islame në botën e re vjen nga Shqipëria Jugosllavia dhe Greqia, dhe është me rëndësi se një numër i madh nga banorët e këtyre vendeve janë në kontakt me vëllezërit e tyre në Shqipëri, pasi që tani i kanë të lejuara vizitat njëri-tjetrit. Aq më tepër kur dihet se me prejardhje shqiptare ka libias, egjiptas, libanez, sirian, saudit dhe shtetas turq të cilët janë të përmendur për kontributin e tyre që kanë dhënë në shkencat të ndryshme bile edhe në shkencat Islame. Në këtë rast vetëm po përmendim sirianin shejh Nasrud-din Albani, shkencëtar eminent i shkencës së hadithit si dhe shkrimtar i njohur Islam. (...)

(Artikulli është nxjerrë pjesërisht nga “Islamska Misao” viti XII, numri 141 – shtator 1990. Në numrin e ardhshëm do të lexoni për muslimanët e Jugosllavisë.)

E përshtati Bahri Aliu

E vetmja rilindje e cila “befason”, të cilën Popoviqi e përmend, është rilindja e bashkësisë muslimane në Jugosllavi (kapitulli VI, faqe 113). Edhe

në këtë kapitull Popoviqi nuk përfill asnjë bashkësi muslimane paraosmane duke përmendur se bashkësia muslimane edhe në Jugosllavi vetorganizohet me vetë ardhjen e osmanlinjëve në këto vende e që fillojnë me marrjen e Manatirit (1382), ndërsa vijën më të largët e arrin me rënien Bihaqit (1592). Bashkësia muslimane është krijuar me ardhjen, por në shumicë me kshkrimin e popullit vendas në Islam. Mirëpo, Popoviqi nuk përfill faktin se boshnjakët dhe shqiptarët kanë pasë fenë bogomile para se masovikisht të pranojnë fenë Islame gjatë shekullit të parë të prezencës së osmanlinjëve. Ai nuk jep shpjegime bindëse për kthimin masovik në Islam, në përjashtim të disa shkaqeve të përshtatshme në të cilat nuk përfillen aspak Islami si fe tërheqëse kur është në pyetje liria e jjeriut për të zgjedhur fenë.

Zbatica e pranisë së osmanlinjëve filloi sikur edhe në vendet tjera, medisfatën e tyre në Vienë në shtator të vitit 1683. Pas asaj disfate në kryengrije më parë u çua Dallmacia me nxitjen e Venedikut. Sipas marrëveshjes paqësore të vitit 1699, Venediku i mbajti nën sundimin e vet territoret e fituara nga Dallmacia. Lufta përsëri plasi në vitin 1714, ndërsa kontrata për paqe e vitit 1718 i lejoi Venedikut që të rrisë numrin e territoreve në Dallmaci. Dallmacia nën Venedikun mbeti deri në vitin 1797, kur bëhet pronë e Austrisë me ndërprerje të shkurtëra deri në vitin 1918. Regjionin e Likës dhe të Kërbavës (momentalisht vende në Kroaci), Austria i fitoi në kohën prej 1685 – 1689, ndërsa Sllavoninë (tash në Kroaci) dhe Vojvodinën në vitin 1714.

Muslimanët e këtyre territoreve, ku me siguri ka pasur mbi 100.000 të cilët me kohë nuk kishin ikur, françeskanët me dhunë i kthejnë në katolicizëm. Vetëm në Likë ka pasur mbi 30.000 muslimanë; shumica prej tyre ikën në Bosnë kurse ata që mbetën me dhunë u detyruan të kthehen përsëri në katolicizëm, andaj në atë territor bashkësia muslimane krejtësisht është fikur, siç ndodhi në Hungari në të njëjtën kohë.

Shteti serb themelohet në vitin 1793, kurse sulltani garanton vetqeverisjen e regjioneve fshatare në rrethin e Beogradit. Kjo bërthamë u zgjërua gjatë shekullit XVIII në dëmtë osmanlinjëve, me ndihmën e Rusisë. Bashkësinë muslimane në ato vende e gjeti i njëjti – migrimi, vrasja, përzënia, kthimi me dhunë në krishterizëm.

Në vitin 1804 vetëm në pashallëkun e Beogradit ka pasur 20.000 muslimanë. Qindra mijë muslimanë jetonin në Serbi para këtyre ndodhive

dramatike. Shumica ishin sllav etnik, të tjerët ishin shqiptarë. Kryengritjet prej vitit 1804 – 1813 dhe në vitin 1815 shkaktoi masakër të muslimanëve, kthim me dhunë etj. deri në vitin 1834 në Serbi mbetën vetëm 15.000 muslimanë, duke jetuar në kushte shumë të vështira të shpërnguljeve kështu që në vitin 1834 numri i muslimanëve në Serbi ra në 12.000 (1% të banorëve të përgjithshëm). Deri në vitin 1866 mbetën vetëm 5.000 muslimanë, ndërsa ky numër u rrit në 6.000 në vitin 1874, 13.000 në vitin 1878, pasi morrën territore të tjera.

Përkundër kësaj Islami u pranua në vitin në vitin 1868, pasi që e morrën Nishin, kurse Bajrakli xhamia e Beogradit përsëri filloi punën, ndërsa ajo në Jagodinë ui meremetua.

Mali i Zi qysh në shekullit e XVI fiton pavarsinë nga pushteti suprem osman. Ndërsa pavarsinë e plotë e fiton në vitin 1878. Në vitin 170 – 1709 popullatën muslimane vendase me të madhe e vranë për çka edhe pasoi shpërbgulja e mkuslimanëve tjerë. Deri në vitin 1878 në Mal të Zi mbetën një numër i vogël i familjeve muslimane.

Pas kryengritjeve të krishterëve të kohëpaskohshme – kryesisht të serbëve – në Bosnë e Hercegovinë në vitin 1875 Austrohungaria e merr atë krahinë në vitin 1878. Popullata muslimane dha rezistencë sidomos në Srajevë. Në vitin 1908 Mbretëria Austrohungareze aneksoi krahinën. Në vitin 1918 pasi morri fund Lufta e Parë Botërore Bosna dhe Hercegovina u bë pjesë e shteteve jugosllave.

Muslimanët e Bosnës dhe Hercegovinës përafërsisht e përbënin gjysmën e banorëve në vitin 1878, ose 50.000 njerëz. Në shumicë ishin boshnjak (sllav etnik). Në kohën prej vitit 1878 – 1918 numri i tyre u rrit, pjesa e tyre në numrin e përgjithshëm pandërprerë u pakësua për shkak të shpërnguljeve të pandërprera për në Turqi (përafërsisht rreth 20.000 të shpërngulur vetëm gjatë viteve 1904 – 1914, ndërsa numerikisht jo më pak se 65.000 prej vitit 1878 – 1913) dhe me ardhjen e të krishterëve.

Muslimanët e Bosnës e Hercegovinës si sllav të jugut nën dnikimin e nacionalizmave duheshte patjetër të vendosin vetë si p.sh. nga nacionalizmi serb (ki8shës ortodokse greke), kroat ( katolik). Gjatë 40 vjetëve mjaft të rënda dhe të vështira shumë u ndihmoi armiqësia reciproke e ortodokësve dhe katolikëve si dhe armiqësia e Austrisë me Serbinë. Bashkësia muslimane filloi të vetëorganizohet në vitin 1882, me vendosjen e institucionit të Reisul

Ulemasë dhe Ulema – Mexhlisit me seli në Sarajevë. Ekzistonin gjatë muftini (në Sarajevë, në Banja Llukë, në Bihaq, në Mostar, në Travnik dhe në Tuzëll). Në vitin 1883 u themelua edhe organizata e vakufit. Në të njëjtën kohë u vendosën edhe gjykatat e sheriatit për muslimanët, kurse në Sarajevë me punë filloi shkolla e Sheriatit. Bashkësia muslimane e Bosnës dhe Hercegovinës pandërprerë luftoi për vetëqeverisjen fetare qysh prej okupacionit Austro-Hungarez, ndërsa vetëqeverisjen e fitoi në vitin 1909. Në periudhën prej vitit 1878 – 1918 normalisht vepronin xhamitë si dhe gjashtë rende të dervishëve.

Për sa i përket shkollimit, bashkësia muslimane e Bosnës e Hercegovinës në vitin 1900 ka pasur 917 mektepe, 43 medrese dhe 28 rushdije. Mësimi fetar ishte i obligueshëm edhe nëpër shkollat e shtetit. Shumë muslimanë shkuan në studime jashtë vendit, nëpër universitete Islame ose në Evropë. Muslimanët përcaktoheshin për shkollimin i cili iu garantonte zhvillimin kulturor më të lartë. Në atë kohë u themeluan shoqata të ndryshme, nga ana tjetër filluan të botohen gazeta dhe revista të ndryshme.

Pas formimit të partive politike muslimanët deshën të ndikojnë edhe në jetën politike. Rreth kësaj çështje Popoviqi përmend pesë parti politike. Periudha prej vitit 1878 – 1918 karakterizohej edhe me fukarallëkun masovik të popullatës muslimane.

Meqë Sllovenia, Kroacia, Dallmacia, Vojvodina dhe Hercegovina ishin nën sundimin Austro-Hungarez, bashkësitë muslimane përsëri u paraqitën në skenë edhe pse gjatë një kohe ishin zhdukur. Në Slloveni dhe Dallmaci bashkësia muslimane zyrtarisht pranohet në vitin 1912, në Kroaci dhe në Sllavoni pranohet në vitin 1916, nga mesi i Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1910 në Kroaci kishte 204 muslimanë, kurse rreth vitit 1916 ka pasur 3.145 muslimanë.

Mali i Zi pavarësinë e vet e fiton në vitin 1878 kështu që në llogari të mbretërisë osmanlije e dyfishoi territorin e vet. Në vitin 1918 pas periudhës së bujshme të Luftës së Parë Botërore, inkorporohet në shtetin e ri jugosllav.

Për shkak të ndryshimeve të pandërprera të kufijve të Malit të Zi dhe ekzodusit masovik të popullatës muslimane, vështirë mund të dihet numri i saktë i muslimanëve në Mal të Zi gjatë viteve 1878 – 1918. Mirëpo, numrin e muslimanëve mund ta gjejmë aty nga viti 1900 kur kishte 12.000 muslimanë (6% prej popullatës së plërgjithshme) kryesisht shqiptarë.



Bashkë me Serbinë , Bullgarinë dhe Rumaninë, Mali i Zi në vitin 1878 nënshkroi kontratën e Berlinit sipas së cilës parashihej mbrojtja e pakicave fetare., kështu u pranua edhe bashkësia muslimane. Ca vite më vonë Meshihati i Stambollit emëroi Muftiun për Mal të Zi me seli në Podgoricë ku u konstituua edhe Drejtorati i sheriatit. Në atë kohë kishte tre kadi (në Podgoricë, në Tivar dhe në Ulqin). Islami ekskluzivisht u pranua edhe në Kushtetutën e vitit 1905. Selia e Muftinisë u shpërngul në Ulqin, ndërsa në vitin 1912 në Tivar. Muslimanët deri diku ishin të lirë të shprehin ndjenjat e tyre fetare, por në vitin 1913 me dhunë kalojnë në krishterizëm të cilën shteti e ndaloi.

Në periudhën prej vitit 1878 – 1918 historia e Serbisë është shumë e pasigurtë, sidomos me ndërrimin e shpeshtë të kufijve. Në vitin 1878 fiton pavarsinë, kurse Sanxhaku, Kosova dhe Metohija i mori në vitin 1912. Në vitin 1901 në Serbi kishte 15.000 muslimanë (prej të cilëve 80% ishin rom). Bashkësia muslimane në Serbi u pttanua në vitin 1878, në krye të cilës ishte Muftiu me seli në Nish. Në Beograd punonte vetëm një xhami (Bajrakli xhamia). Edhe një xhami punonte në Nish. Shkolla muslimane në Nish është mbyllur para viti 1907, ndërsa vakufet në Serbi shumë më herët u konfiskuan.

Pasi e morën Sanxhakun, Kosovën dhe maqedoninë, Muftiu i Nishit u nftgri në nivelin e Muftiut të lartë; Islami u pranua, e u organizuan bashkësi muslimane me territore të reja (më shumë se 500.000 njerëz).

Sanxhaku i Novi Pazarit iu bashkangjiti Serbisë në vitin 1912. Muslimanët e Sanxhakut ishin boshnjakë (sllav etnik). Popoviqi nuk jep të dhëna për muslimanët e Sanxhakut. Por, regjistrimi osman i vitit 1895 për krahinën e Shkupit e cila ka qenë pjesë e Sanxhakut, që ka përfshirë Kosovën dhe pjesë veriore të Maqedonisë së sotshme, përmend numrin gjithsejtë 945.000 banorë prej të cilëve 50% kanë qenë muslimanë (548.000). krahina e Manastirit e cila përfshinë pjesën jugore të Maqedonisë së sotshme dhe pjesët e Greqisë së sotshme dhe Shqipërinë kishte 730.000 banorë prej të cilëve 34% ishin muslimanë (248.000). (...)

Në Jugosllavinë jugore, ku muslimanët ishin etnikisht të ndryshëm (boshnjakë, maqedonë, rom, shqiptarë, turq) gjendja nuk ishte e kënaqshme. Serbët të cilët mendonin se i kanë çliruar vednet e paraardhësve të tyre,

shumë keq silleshin me muslimanët. Përveç kësaj, muslimanët në jug vuajtën për shkak të nacionalizmit serb dhe atij shqiptarë.

Shpërngulja e muslimanëve prej Jugosllavie në Turqi vazhdoi prej vitit 1918 – 1941, shpërnguleshin më tepër turq e më pakë boshnjakë. Shqiptarët e Kosovës shpërnguleshin në Shqipëri dhe në Turqi; u shpërngulën rreth 140.000 në atë kohë...

Vlerësohet se në vitin 1921 në Jugosllavi ka pasur rreth 1.338.000 muslimanë, duke iu bashkangjitur: 558.000 muslimanë të BeH, 23.000 muslimanë të Malit të Zi, 4.000 muslimanë të Koroacisë, si dhe 723.000 të Serbisë dhe “Serbisë Jugore”, së bashku me shqiptarët 442.000 dhe 148.000 turq. Në vitin 1931 numri i popullatës muslimane në Jugosllavi rritet në 1.601.000 (Popoviqi përmend një numër më të vogël) ose 11,5% nga numri i përgjithshëm 13.934.000 banorësh. Prej tyre rreth 718.000 muslimanë ka pasur në Bosnë e Hercegovinë, 5.000 muslimanë në Kroaci dhe 878.000 në pjesët tjera të vendit.

Në vitin 1919 shteti i ri garantoj të drejtat fetare dhe gjuhësore të pakicave si dhe garantoj institucionet Islame. Në suaza të Ligjit bashkësia muslimane në Bosnë e Hercegovinë u organizua në vitin 1909, në Serbi dhe në Mal të Zi në vitin 1919, në Slloveni dhe në Dalmaci në vitin 1912, në Kroaci në vitin 1916. Të gjitha këto ligje u unjësuan në një Ligj më 21 mars të vitit 1929, ndërsa Bashkësia Fetare Islame u organizua në vitin 1930 në krye të Reisul Ulemasë me seli në Beograd. Nën kontrollin e Reisit ishin dy Ulema Mexhlise si dhe dy administrata të vakufëve (në Sarajevë dhe në Shkup).

Muslimanët e Jugosllavisë rregullisht kanë shkuar në haxh në periudhën prej vitit 1918 – 1941. Gjatë asaj kohe janë themelua shumë shoqata fetare (Popoviqi përmend dymbëdhjetë). Muslimanët u orvatën që të vëndojnë lidhje me ummetin, andaj një delegacion merr pjesë në Kongresin e parë të muslimanëve të Evropës i cili u mbajtë në vitin 1935. Shkollimin Islam e mundësonin medresetë dhe mektebet në tërë vendin. Në vitin 1918 u poashtu në Sarajevë. Vetëm në Bosnë e Hercegovinë pas vitit 1918 ka pasur 40 medrese, numri i të cilave në vitin 1930 u zvogluas në 20, dhe 73 medrese në vende tjera të vendit. Në vitet e 30-ta shteti hapi nëntë medrese të reformuara prej të cilave katër në Bosnë e Hercegovinë (në Srajevë, në Tuzëll, në Travnik, në Bihaq) dhe pesë në pjesët tjera të vendit. Më të

njohurat ishin medreseja e Husref Beut në Sarajevë dhe medreseja e Isa Beut në Shkup. Ekzistonin tri shkolla të shariatit, që të trijat në Sarajevë.

Gjatë kësaj periudhe (1918 – 1941) është zhvilluar një veprimtari shumë e madhe kulturore në bashkësinë muslimane e përqëndruar kryesisht në Bosnë e Hercegovinë. Ekzistonin shumë gazeta, edhe Popoviqi përmend dhjetëra botime periodike, të shumtat botoheshin në gjuhën serbokroate në territorin e Bosnë e Hercegovinës.

U themeluan shumë parti politike muslimane. Popoviqi përmend nëndë parti të Bosnë e Hercegovinës dhe tri në Serbinë Jugore. Veprimtaria e reformës agrare mes dy luftërave botërore rëndë i goditi muslimanët dhe vakufet e tyre. Varfërimi i bashkësisë muslimane posaçërisht hetohet në “Serbinë e Jugut”.

Periudha prej vitit 1941 – 1945 në masë të madhe ishte tragjike dhe traumatike për muslimanët si dhe për popullin tjetër të Jugosllavisë. Shteti jugosllav u shkatërrua në turrin e ushtrive të huaja, të shteteve satelite, e të stacionuara në Kroaci (duke bashkangjitur edhe Bosnën e Hercegovinën), Serbinë dhe Malin e Zi, ndërsa territoret tjera të Jugosllavisë i pushtuan Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Gjermania dhe Italia.

Rezistenca jugosllave për brenda është e organizuar. Në fund udhëheqjen e rezistencës e merr partia komuniste e cila me ndihmën e Armatës së kuqe e çliroi vendin dhe në vitin 1945 përsëri themeloi shtetin Jugosllav.

Bashkësia muslimane e Jugosllavisë shkatërrohet në prill të vitit 1941 bashkërisht me vendin, në një shumë bashkësi territoriale. Prej vitit 1941 – 1945 pandërprerë vazhdoi therrja në mes boshnjakëve (muslimanë) dhe serbëve të cilët në Bosnë e Hercegovinë të cilët në mënyrë reciproke ndjellnin armiqësinë. Ndodhitë gjatë Luftës së Dytë Botërore shkaktuan vdekjen e më shumë se 930.000 jugosllavëve, duke iu bashkangjitur më shumë se 100.000 muslimanë, pre të cilëve  $\frac{3}{4}$  në Bosnë e Hercegovinë.

Gjatë periudhës prej vitit 1941 – 1945, në Zagreb (Kroaci) u hap një xhami në vitin 1944, dhe vepronin katër organizata muslimane. Shkollat e muslimanëve edhe më tej punojnë pak a shumë mirë, si dhe vazhduan të botohen pesë gazeta. Mirëpo, punën e ndërprejnë të gjithë partië muslimane. Patë muslimanë të cilët iu bashkangjitën lëvizjes nacionale të cilën e udhëheqte partia komuniste.

Pas luftës, Jugosllavia përsëri u themelua si pushtet nën udhëheqjen e partisë komuniste të cilën e përbënin gjashtë shtete: Sllovenia, Kroacia, Bosna dhe Hercegovina, Serbia me dy krahinat autonome Kosovën dhe Vojvodinën, Mali i Zi dhe Maqedonia. Mirëpo, në vitin 1948 kominformi i gjykoi udhëheqësit jugosllavë. Më vonë Jugosllavia u bë udhëheqëse e Lëvizjes së shteteve të painkuadruara.

Popoviqi pretendon se në këtë moment në Jugosllavi ka mbi 300.000 muslimanë. Ky vlerësim haptazi shihet se është shumë i vogël. Pengesat që të vijmë deri te një numër shumë i saktë dalin nga fakti se nuk ekzistojnë grafa e cila do të përfshinte regjistrimin e popullatës me përkatësi fetare. Muslimanëve iu përkasin: shqiptarët, turqit, romëst ose sllavët. Muslimanët sllav të Bosnës dhe Hercegovinës deklarohen si boshnjakë, por pushteti jugosllav nuk don të pranojë këtë nacionalitet. Boshnjakët muslimanë deri në regjistrimin e vitit 1967 në shumicë deklarohen si jugosllav, disa si kroat dhe një numër si serb. Krahas këtyre ekzistojnë muslimanë të nacionaliteteve maqedonas dhe malazes. Në vitin 1967 pushteti pranon nacionalitetin “musliman” në Bosnë e Hercegovinë. Pas kësaj shumca e muslimanëve regjistrohen si “Musliman”, ndërsa ca të tjerë ende vazhduan të përcaktohen si kroat, serb apo jugosllav. Vlerësimet e mia për popullatën muslimane në Jugosllavi të bazuara në rezultatet e regjistrimit mund të shihen në tabelën që vijon:

Etniteti	Viti 1953	Viti 1971	Viti 1981
Muslimanë jugosllav	1.117.000	2.022.000	2.884.000
Shqiptarë	754.000	1.310.000	1.731.000
Turq	250.000	128.000	101.000
Rom	60.000	78.000	149.000
Gjithsejtë:	2.177.000	3.538.000	4.825.000
Përqind. nga popull. e përgjithshme	12,8%	17,4%	21,5%

Vendi	Viti 1971		Viti 1981	
	Nr. i banor.	Përqindja	Nr. i banor.	përqindja
Bosna dhe	1.541.000	41,5%	2.130.000	51,6%

hercegovina				
Kosova	1.011.000	81,0%	1.360.000	85,6%
Maqedonia	418.000	25,0%	600.000	31,4%
Mali i Zi	119.000	22,4%	150.000	25,7%
Serbia pa krahinat	303.000	6,0%	400.000	7,0%
Kroacia	124.000	3,0%	150.000	3,3%
Sllovenia	10.000	0,5%	20.000	1,1%
Vojvodina	12.000	0,5%	15.000	0,7%

### **Si është gjendja tani?**

Muslimanët në Bosnë e Hercegovinë janë në shumicë. Të dhënat dhe regjistrimi i vitit 1981 (në faen 344) tregon se ka 2.000.000 “Muslimanë” (sipas kombësisë don të thotë se ata janë boshnjakë), mirëpo në faqen 377 Popoviqi vërteton se muslimanë (në kuptim fetar) ka 1.5 dhe 2 milionëve. Në të vërtetë ka rreth 2.130.000 muslimanë (në kuptim fetar) nëse llogaritim romët, shqiptarët, kroatët dhe jugosllavët. Ky është numri më i madh i muslimanëve në një prej shteteve jugosllave. Në vitet e tetëdhjeta vjen deri te ndjekja e shumë mendimtarëve muslimanë “krim” i vetëm i të cilit ishin vetëm Islami, i cili arriti kulminacionin në vitin 1983 përmes akuzave të paargumentuara, me burgosjen e 11 mendimtarëve muslimanë, për çka muslimanët e Jugosllavisë dhe jasht saj i përkujtoi në fazën më të vështirë të zhvillimit të bashkësisë muslimane e sidomos ata të pas Luftës së Dytë Botërore.

Grupin e dytë të muslimanëve të Jugosllavisë e përbëjnë muslimanët e Kosovës ku në vitin 1981 ka pasur 1.360.000 dhe e përbënin 85.6% të popullatës së Kosovës. Kjo popullatë kryesisht është shqiptare. Në vitet e tetëdhjeta nacionalizmi shqiptarë luftoi për pranimin dhe ngritjen e Kosovës në nivel konstituiv të republikës në Jugosllavi, e jo më në nivel të krahinës autonome në Serbi. Kjo kulminoi në shqetësimet e prillit të vitit 1981.

Grupi i tretë i muslimanëve janë muslimanët e Maqedonisë e që janë 600.000 dhe e përbëjnë 31.4% të popullatës sipas regjistrimit të vitit 1981. Ata janë të kolektivitetëve të ndryshme: shqiptarë, maqedonë, turq dhe romë. Suksesi më i lartë është hapja e sërishme e medresesë së Isa Beut në Shkup në vitin 1984, e cila ishte nxitje e madhe për muslimanët e Maqedonisë;

shpërngulja e turqëve; interesimi zyrtar për migracionin e shqiptarëve; dhe kohë pas kohe sulmi i pushtetit republikan kundër Islamit.

Në Mal të Zi në vitin 1981 ka psaur 180.000 muslimanë,ose 25,7% të banorëve të përgjithshëm. Kjo është zgjim rishtas i kësaj bashkësie. Në Serbi, pa krahinat, muslimanët (boshnjak) jan të koncentruar në territorin e Sanxhakut dhe në selinë shtetërore në Beograd. Në Kroaci bashkësia muslimane u zhvillua në mënyrë fantastike pasi u vendos pushteti pas Luftës së Dytë Botërore, edhe pse xhamia e ndërtuar në vitin 1944 u rrëzua, qendra e bashkësisë muslimane u ndërtua rishtaz dhe u hap në korrik të vitit 1987, pas shumë pengesave të pushtetit. (Këto fakte Popoviqi nuk i përmend...) ekziston q enrda islame edhe në Lubjanë (Slloveni) dhe një bashkësi muslimane e vogël në Vojvodinë. Në fund vlenë të përmendim se shumica e muslimanëve të Jugosllavisë janë boshnjakë dhe shqiptarë të cilët në kohën më të re kanë marrë vendet më të larta në shtet dhe në pjesët e tij konstituive.

(Artikulli është nxjerrë pjesërisht nga “Islamska Misao” viti XII, nr. 141 – shtator 1990.)